

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- Departamenti për Krime të Rënda, në përbërje të gjyqtarit Gëzim Pozhegu Kryetar i trupit gjykues, gjyqtareve Myfera Hoxha dhe Manduhije Syla anëtare të trupit gjykues si dhe sekretares juridike Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit N. H. nga Gjakova, për shkak të dy veprave penale të kryera veç e veç: të kontrabandimit me migrantë në tentativë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me aktakuzën PP/I.nr.45/2015 e datës 28.04.2015 dhe me aktakuzën PP/I.nr.54/2017 e datës 30.06.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë **06.09.2017**, në prezencën e Prokurorit Ali Uka, të akuzuarit N. H. dhe mbrojtësit të tij avokat Agim Muhaxhiri nga Gjakova si dhe të dëmtuarve M., V. dhe T. Sh., më datë **06.09.2017**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N. H.**, i biri i A. dhe nënës S., e gjinisë P., data e lindjes..., në Gjakovë, tani me banim ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë.

Është Fajtor

Se më datë 24.02.2015 është marrë me kontrabanimin e emigrantëve, në atë mënyrë që pasi më parë ka arritur marrëveshjen gojore me dëshmitarët-të dëmtuarit K. K. nga fshati B., Komuna e Malishevës, F. B. nga fshati C., Komuna e Malishevës, E. M. nga fshati V., Komuna e Malishevës që përmes rrugës ilegale ti dërgojë në Itali, ashtu që nga secili prej tyre kur të arrijë në shtetin e Italisë, i pandehuri N. së bashku me shtetasin bullgarë kanë patur për ti marrur nga 1.500,00 €, dhe se ditën kritike me automjetin taksi me tabela të Bullgarisë, të cilin e ka drejtuar shtetasi bullgar I. D., e në të cilin automjet ishte edhe i pandehuri N. H. nisen nga qyteti i Gjakovës, duke kaluar kufirin Kosovë-Shqipëri, në Vërmicë, më pastaj nga Shqipëria kanë kaluar përmes territorit të Malit të Zi dhe Bosnje Hercegovinës dhe në momentin kur arrin në territorin e Kroacisë, ndalohen nga policia Kroate, ashtu që shtetasin bullgar I. D., policia kroate e arreston, gjersa të pandehurin N. H. dhe të tjerët i kthejnë prapa në Bosnje Hercegovinë, e që më pas nga autoritetet përkatëse të njëjtit kthehen në Kosovë.

- **me çka ka kryer veprën penale kontrabandimi me migrantë në tentativë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.**

Gjykata në mbështetje të nenit 6, 17, 41, 43, 51, 73, 75, e 76, nenit 170, par. 1, lidhur me nenin 28 të KPRK-së si dhe neneve 359 par.2, 366, 450, të KPPK-së, të akuzuarin e,

G J Y K O N

DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ DYQINDË (200) €,

Dhe

ME DËNIM ME BURG NE KOHËZGJATJE PREJ GASHTË (6) muajve, në të cilin dënim në bazë të nenit 83 llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 16.06.2017 e deri më 06.09.2017.

kështu që në bazë të nenit 51 par. 1 dhe 2 të KPRK-së

I shqiptohet

DËNIM ME KUSHT

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, që iu është shqiptuar të akuzuarit N. H. nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari N. H. në afat prej dy (2) vite nuk kryen vepër tjetër penale.

Nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet brenda afatit të paraparë atëherë i njëjti dënim me gjobë, i zëvendësohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga njëzetë (20 €).

Në kuptim të nenit 450 parg.4 të KPPK-së, i akuzuari obligohet që të paguajë shpenzimet procedurale penale në shumë prej 25 euro si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 euro, e krejt këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së, palët e dëmtuara udhëzohen që kërkesën pasurore juridike të realizoi në kontest civil.

Bazuar në nenin 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së:

REFUZOHET AKUZA

Se më datë 16.06.2017 është marrë me kontrabanimin e emigrantëve, në atë mënyrë që pasi më parë ka arritur marrëveshjen gojore me dëshmitarët - të dëmtuarit M. Sh. që përmes rrugës ilegale ti dërgojë në Itali, ashtu që nga që së bashku me të dëmtuarin M. ti dërgojë edhe dëshmitarët-të dëmtuarit T. dhe V. Sh. dhe se për të tretë ka kërkuar gjithsejtë 7.500,00 €, për secilin nga 2.500,00 € gjersa ditën kritike i dëmtuari M. ia jep 490 € në çastin kur janë nisur nga stacioni i autobusëve në Gjakovë dhe me të arritur në stacionin e autobusëve në Prizren hypin në autobusin , i cili qarkullonte në relacionin Prizren-Beograd dhe me të arritur në pikën kufitare në Merdare pas kontrollit të bërë të udhëtarëve, i njëjti është ndalur nga ana e policisë në bazë të një letërrreshtimi vendor të lëshuar nga ana e Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe ate për një rast tjetër penal nën Pkr.nr.76/15 dhe më pas është vërtetuar se personat e lartcekur ishin me të he atë duke i dërguar përmes rrugës ilegale për në Itali, ashtu që i njëjti është arrestuar nga ana e policisë.

- **Me çka kishte për të kryer veprën penale kontrabandimi me migrantë në tentativë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së**

Për shkak të tërheqjes së prokurorit nga ndjekja penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë ka ngritur aktakuzat PP/I.nr.45/2015e datës 28.04.2015 dhe PP/I.nr.54/2017 e datës 30.06.2017, kundër të akuzuarit N. H. nga Gjakova, për shkak të dy veprave penale të kryera veç e veç : të kontrabandimi me migrantë në tentativë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Meqenëse i njëjti nuk iu është përgjigjur thirrjeve të gjykatës dhe nuk e ka arsyetuar mos prezencën e tij në shqyrtimet e caktuara nga gjykata, për të njëjtin Kryetar i trupit gjykues ka është lëshuar Letërrreshtim vendor për sigurinë e tij në procedurën e mëtutjeshme penale.

I akuzuari N. H. është arrestuar me datë 16.06.2017 dhe është sjellur në gjykatë në bazë të letërrreshtimit vendor. Ku të njëjtit iu është caktuar masa e paraburgimit.

Për çështjen penale sipas aktakuzës PP/I.nr.45/2015e datës 28.04.2015 është mbajtur shqyrtimi fillestar me datë 28.06.2017 ku i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë. Ndërsa për çështjen penale sipas aktakuzës PP/I.nr.54/2017 e datës 30.06.2017 është mbajtur shqyrtimi fillestar me datë 14.07.2017 , në shqyrtimin fillestar të mbajtur me 14.07.2017 , është bërë bashkimi i lëndëve Pkr.nr.76/15 dhe Pkr.nr.70/17 dhe procedura penale lidhur me këto çështje është zhvilluar me numrin Pkr.nr.76/15.

Shqyrtimi i dytë lidhur me këtë çështje penale është mbajtur me datë 14.08.2017.

Prokurori Ali Uka në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se : Propozojë gjykatës që të mos shkohet në administrimin e provave materiale dhe dëgjimin e këtu të akuzuarit N. H., meqenëse gjatë administrimit të të gjitha provave në këtë shqyrtim gjyqësor dhe ate sa i përket veprës penale nga aktakuza PP/I.nr.54/2017 datës 30.06.2017 dhe ate për vepër penale në tentativë: kontrabandim me migrantë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, gjatë kësaj procedure gjyqësore dhe ate duke u mbështetur dhe në deklaramet e dëshmitarëve përkatësisht të dëmtuarve M., V. dhe T. Sh. që të gjithë nga Gjakova, nuk u arrit që të provohet fajësia e këtu të akuzuarit N. H. dhe ate për vepër penale si në aktakuzë.

Po ashtu duke u nisur edhe nga motivi se këtu të dëmtuarit për shkaqe ekonomike kanë dashur që të shkojnë në një shtet tjetër përkatësisht në Itali, e po ashtu edhe për qëllime të bashkimit familjar si dhe rrethanave tjera deklarojë se tek i akuzuarit N. H. nuk ka qenë qëllimi i ndonjë përfutimit material meqenëse edhe i njëjti ka pasur për qëllim që të largohet nga Kosova dhe ate për të gjetur një jetë më të mirë, andaj deklarojë se duke u mbështetur në të gjitha të lartcekurat HEKI DORË NGA AKTAKUZA dhe ndjekja penale për këtu të akuzuarin N. H. dhe ate për vepër penale nga aktakuza PP/I.nr.54/2017 datë 30.06.2017.

Pasi që prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit N. H., gjykata bazuar në nenin 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPP-së, ka marr aktgjykim me të cilin e ka refuzuar akuzën për veprën penale sipas aktakuzës PP/I./nr.54/2017 datë 30.06.2017 .

Sa i përket çështjes penale PKR.nr.76/15, sipas aktakuzës PP/I./nr.45/2015 datë 28.04.2015, Gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 326

të KPK-së, kështu që pas konsultimeve të bëra i akuzuari N. H. ka deklaruar se e kupton aktakuzën dhe deklaroi se ndihet fajtor dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pas deklarimit të të akuzuarit N. H., për pranimin e fajësisë Kryetari i trupit Gjykes kërkon që mendimin e vetë ta jap edhe Prokurori i Shtetit Ali Uka, i cili deklaroi se : PP/I.nr. 45/2015 datë 28.04.2015 këtu i akuzuari pranoi fajësinë për veprën penale nga a aktakuza dhe duke qenë të bindur se ky pranim i fajësisë nga ana e tij është bërë me vullnet dhe pa presion, i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimin të fajësisë të cilat ia referojë gjykata në këtë shqyrtim gjyqësor, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat e siguruar gjatë hetimeve dhe të propozuara në aktakuzë andaj deklaroi se mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze, i propozojë gjykatës që të njëjtin ta shpalli fajtor, ta gjykojë sipas ligjit, ta obligojë në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale, gjersa sa i përket caktimit të lartësisë dhe llojit të dënimit i propozojë gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merret për bazë, pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit N. H., Av. A. M. ka deklaruar se : Sa i përket veprës së parë për lëndën Pkr.nr.70/17, nuk kam asgjë të shtojë, ndërsa sa i përket aktakuzës PP/I.nr.45/2015 datës 28.04.2015, shtojë se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë me vullnetin e tij, pa dhunë, presion, apo të metë tjetër. Sa i përket pranimin të fajësisë i pandehuri ka pasur për qëllim edhe vet shkuarjen në Itali, për faktin se atje e ka vëllaun, këtu është i papunë dhe nuk ka kurrfarë të ardhura, përkatësisht nuk ka mjete financiare për ekzistencë, kjo e ka shtyrë që i njëjti të tentojë të migrojë. Me rastin e marrjes së vendimit trupit gjykes, i propozojë që të ketë për bazë gjitha rrethanat lehtësuese, gjendjen e dobët ekonomike, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit, si dhe faktin se vepra penale për të cilën ngarkohet ka mbetur në tentativë , dhe për të njëjtin fakt nuk ka realizuar kurrfarë të mira materiale nga veprimet e tija. Andaj i propozojë gjykatës që ti shqiptojë një dënim sa më të butë , me kusht apo shqiptim të dënimit me të holla duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. I njëjti premtojë se në të ardhmen nuk do të kryej veprën të tillë penale.

Në vijim Gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, vlerësojë se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe në mbështetje të fakteve të propozuara në aktakuzë, konform nenit 326 të KPK-së.

Duke pasur parasysh se Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 të KPRK-së si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk u zbatua procedura e provave dhe fjala përfundimtare.

I akuzuari N. H., deklaroi se e ndien veten të penduar thellësisht dhe premtonte se nuk do të përsërisë një veprë të tillë në të ardhmen.

Nga gjendja faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij Aktgjykimi pa dyshim rrjedhë se në veprimet e të akuzuarit N. H. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale : trafikimi me migrantë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethanat të cilat do të zvogëlonin ose përjashtonin përgjegjësinë penale të të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.5/3, të KPK-së.

Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin N. H., Gjykata mori gjendjen e dobët ekonomike, keqardhjen e shprehur për veprën e kryer penale, dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale, pranim që sipas vlerësimit të Gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tij, e duke i vlerësuar

këto rrethana lehtësuese konform nenit 73,74 dhe 75 të KPK-së të akuzuarin e gjykon si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me të cilin do të arrihet dhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuara me nenin 73 par.1 të KPRK-së, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur të shoqërisë.

Gjykata po ashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do t'i shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, dhe ky dënim do të ketë efekt preventivë gjeneral për personat e tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 363 par. 1 nën par. 1.1 dhe neni 365 par.1 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas shpalljes së këtij aktgjykimi gjyqtari i udhëzojë palët me të drejtë ankese, se mund ta parashtronë në përputhje me nenin 368. par.1 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë
PKR. nr. 76/15 me datë 06.09.2017

Sekretarja juridike,
Arbënore Basha

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,
Gëzim Pozhegu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej **15 dite**, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit, e nëpërmjet kësaj Gjykate.